



UNMIK



IPVQ

INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISESE  
 PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
 PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA  
 QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT	MINISTRY OF EDUCATION	MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISE	SCIENCE & TECHNOLOGY	NAUKU I TEHNOLOGIJU
Kabineti i Ministrat	Office of the Minister	Kabinet Ministra

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**

Zbatimi i planit dhe programit të punës edukative-arsimore me nxënës të institucioneve të arsimit special

NUMËR : 49 /2007

DATË: 16.11.2007

Në bazë të pikës (b) të nenit 6.1, pikës (c) të nenit 15.1, nenit 35 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm si dhe në bazë të pikës (d) të nenit 1.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 mbi Degën e Ekzekutiv të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), si dhe paragrafit 7 të nenit 25 të Rregullores së Qeverisë nr. 01/2007 për punën e Qeverisë, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë Udhëzim administrativ:

**Neni 1**

**Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është zbatimi i planit dhe programit të punës edukative-arsimore me nxënës të institucioneve të arsimit special si rezultat i ristrukturimit të sistemit të arsimit.

**Neni 2**

**Planprogrami**

Plani dhe programi i punës edukative-arsimore në institucione për nxënës që vijojnë arsimin special i është bashkangjitur këtij Udhëzimi administrativ.

**Neni 3**

**Zbatueshmëria**

1. Ky plan dhe program i punës edukative-arsimore me nxënës të institucioneve të arsimit special zbatohet nga viti shkollor 2007/2008.
2. Me zbatimin e planit dhe programit të punës edukative -arsimore me nxënës të insitucioneve të arsimit special plotësohet një zbrazëti që ka ekzistuar deri më tani në punën e edukatoreve me këtë kategori nxënësish.

**Neni 4**

**Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri.

Agim Veliu, ministër

